

---

## **“RUNFILL” SH.P.K.**

**Arbanë-Barikadat, p.n., Komuna Prizren**



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN E PRODHIMIT TË PRODUKTEVE PER PASTIM - DETAJIM, SHAMPONËVE DHE AROMAVE PËR MAKINA NGA KOMPANIA “RUNFILL” SH.P.K.**

**Prizren, Prill – 2024**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN E  
PRODHIMIT TË PRODUKTEVE PER PASTIM - DETAJIM, SHAMPONËVE  
DHE AROMAVE PËR MAKINA NGA KOMPANIA “RUNFILL” SH.P.K.**

**Me adresë në Arbanë-Barikadat, p.n., Komuna Prizren**

**Parcela ku zhvillohet veprimtaria e kompanisë është me nr. 00314-9, Zona kadastrale  
Dushanovë, Komuna Prizren**

	<b>Emri I Investitorit</b>	<b>Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së</b>
Aplikuesi	<b>Reshat Güner</b>	<b>Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari</b>
Investitori:	<b>“RUNFILL” SH.P.K. Pronar: Nurcan Güner</b>	
Adresa:	<b>Dushanovë Arbanë-Barikadat, p.n., Komuna Prizren</b>	<b>Gllgoc</b>
Lokacioni i Fabrikes se prodhimit	<b>Dushanovë Arbanë-Barikadat, p.n., Komuna Prizren</b>	
Tel:	<b>+383 49 376 106</b>	<b>+383 49 588 634</b>
Email:	<b>resatguner@hotmail.com</b>	<b>Blerinabajraktari1@gmail.com</b>

  
Nënshkrimi

Nënshkrimi

Prizren - Datë: 08.04.2024

## Përmbajtja:

1.	HYRJE .....	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së .....	1
3.	PËR KOMPANINË.....	3
	a) Vendndodhja e Fabrikes .....	4
	b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	6
	c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit .....	7
	d) Përshkrimi detal i procesit teknologjik .....	8
	e) Përllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit .....	21
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME .....	22
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT .....	23
	5.1 Ndotsit Kryesorë .....	24
	5.2 Transporti rrugor .....	24
	5.3 Mbeturinat e ngurta.....	24
	5.4 Ndotësit nga burimet agro-kemikale.....	25
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS .....	25
	6.1 Ndikimet në ajër.....	26
	6.2 Ndikimet në tokë.....	26
	6.3 Ndikimet në ujë.....	26
	6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë .....	27
	6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	27
	6.6 Ndikimet nga zhurma.....	27
	6.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	27
	6.8 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat .....	28
	6.9 Trashëgimia Kulturore .....	28
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS .....	29
8.	PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE .....	30
9.	PERSHKRIMI I MASAVE.....	32
	9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër .....	32
	9.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë .....	33
	9.3 Masat për mbrojtje nga zhurma .....	34
	9.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë .....	34
	9.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë .....	34
	9.6 Masat rehabilituese .....	34
	9.7 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve .....	35
	9.8 Menaxhimi i mbeturinave .....	36
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE .....	37
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	37
12.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME.....	37
	12.1 Përshkrimi i shkurtër i procesit .....	37
13.	PËRFUNDIM .....	38
14.	LITERATURA E PERDORUR .....	39

## Lista e Figurave:

Figura 1	Objekti i Kompanise ku e zhvillon aktivitetin e saja Kompania " RUNFILL" SH.P.K.....	3
----------	--	---

Figura 2 Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë në territorin administrativ të K. PRIZREN ...	4
Figura 3 Lokacioni i kompanisë “RUNFILL” SH.P.K. nga qendra e K. PRIZREN.....	5
Figura 4 Ortofoto dhe Plani i Situacionit ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë.....	5
Figura 5 Objekti ku e zhvillon veprimtarinë kompania "RUNFILL" SH.P.K. Arbanp, Komuna Prizren .....	6
Figura 6 Dukja 2D e procesit të punës së fabrikës së prodhimit .....	7
Figura 7 Skema e procesit teknologjik.....	20
<b>Lista e Tabelave:</b>	
Table 1 Mbeturinat të cilat gjenerohen nga kompania .....	28

## **1. HYRJE**

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një dokument i rëndësishëm dhe i nevojshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë ku pas plotesimit të kushteve nga Pelqimi Mjedisor Investitori duhet të aplikoj pastaj për marrjen e lejes mjedisore dhe operimin e Fabrikes së prodhimit të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina. Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mundë të paraqiten në relacionin e fabrikes se prodhimit të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina duke pasur parasysh mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë. Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis për fabriken të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtarit punuese (shërbim, transport, deponim, trajtimi i lendeve të para etj.), në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për fabrikën për prodhim të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina nga kompania “RUNFILL” SH.P.K. me lokacion në lagjen Arbana apo Dushanovë, Komuna Prizren, është punuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikes se kompanisë “RUNFILL” si dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së të Fabrikës së Prodhimit, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse kompania ka marrur me qera objektin dhe nuk e ka ndërtuar vetë për të cilin paguan dhe qera.

## **2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së**

Bazuar në karakteristikat e fabrikes se prodhimit të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të perfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 4:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060,
- Lligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110,
- Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate

Udhëzimet administrative:

- UA mmph - nr. 23/2015 për eksport ,import dhe tranzit te kimikateve te caktuara te rrezikshme pic- proceduara,
- UA (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor,
- Udhëzim Administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

### 3. PËR KOMPANINË

Kompania “RUNFILL” SH.P.K. duke e parë rritjen e kërkesave të produkteve të aromave për detajim dhe pastrim të makinave si dhe shamponave ka hapur fabriken me lokacion në lagjen arbana-dushanovë e cila gjendet në afersi të rrugës ne R107 në Komunen e Prizrenit. Në fabrikën e prodhimit të të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, kemi një gërshetim funksionesh, si: afarizëm dhe tregeti, deponimi dhe funksione teknike etj. Të gjitha këto funksione janë komplementare mes veti dhe e rrisin kualitetin e shfrytëzimit në këtë objekt.



Figura 1 Objekti i Kompanise ku e zhvillon aktivitetin e sajë Kompania " RUNFILL" SH.P.K.

Kompania ne fjale pas marrjes se procesverbalit nga inspektorati qendror mjedisor ka filluar me pergatitje dhe kompletimin e dokumentacionit per tu pajisur me Pëlqim Mjedisore nga MMPHI por per arsye te rritjes se kapacitetit dhe futjes se makinerise per prodhim, është urdheruar që të aplikoj për Pëlqim Mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Duke u bazuar në rritjen e kërkesave dhe shfrytëzimin maksimal të produkteve të produkteve të aromave dhe shamponave për pastrim të makinave kompania deri me tani ka bërë vetëm

importin dhe shitjen e produkteve të lëndës së parë, aromave dhe shamponave te gatshem por kompania ne fjale ka planifikuar qe ta bej vet prodhimin e produkteve, aromave dhe shamponet per pastrim te makinave.

Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 4. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të marrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis. Fabrika per prodhim të produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina është e ndërtuar në Parcelën me nr. 00314-9, Zona kadastrale Dushanovë, ku prona dhe fabriken investitori i kompanise “RUNFILL” SHPK e ka me qera dhe jane ne emer te nje pronari tjetet.

### a) Vendndodhja e Fabrikes

Objekti i Fabrikes se prodhimit të produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina ndodhet në ngastren kadastrale me nr. 00314-9, Zona kadastrale Dushanovë, Komuna Prizren. Kompania “RUNFILL” SH.P.K., ndodhet në pjesën veriore të territorint administrativ të komunës së Prizrenit afer rruges Rajonale Prizren - Gjakovë.




Figura 2 Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë në territorin administrativ të K. PRIZREN






Figura 3 Lokacioni i kompanisë “RUNFILL” SH.P.K. nga qendra e K. PRIZREN




Figura 4 Ortofoto dhe Plani i Situacionit ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë

**b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit**

Duke u bazuar në atë se kompania RUNFILL SHPK, shfrytëzon objektin sipas kontratës për qera, objekti së pari ka qenë si depo universale ku kompania në fjalë ka bërë vetëm shitje të produkteve për pastrim dhe arome për makina, ndërsa tani ka planifikuar të bëjë edhe prodhim të produkteve të ndryshme për pastrim, aroma dhe detajim të cilat do të përdoren për pastrim të makinave.

**Objekti i kompanisë është P+0 – me sipërfaqe prej 180 m<sup>2</sup>:**

Objekti i plotëson të gjitha kushtet për shitje dhe prodhim të të gjitha të produkteve për pastrim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina.



*Figura 5 Objekti ku e zhvillon veprimtarinë kompania "RUNFILL" SH.P.K. Arbanj, Komuna Prizren*

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Me poshtë paraqesim përshkrimin e veçorive kryesore të fazës operative të Fabrikes se prodhimit të produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina nga kompania “RUNFILL” SH.P.K.




Figura 6 Dukja 2D e procesit te punes se fabriks se prodhimit

Sa i përket komponentëve kryesore, dhe ato ndihmëse janë:

Tabela 1 Lista e kemikateve qe importohen si lëndë e parë

Lëndët e para që do të përdoren në import dhe në prodhim.					
Nr	Emri Kimikatit	Emri kimik	Nr/Kocli Doganor	Nr.EC Nr.CAS	Sasia per import
1	Sodium Hydroxide	Coustic flekes (COUSTIC SODA)	2815.1100.00.00	215-185-5 1310-73-2	3.000 kg
2	Hydroxyethylidene Diphosphonic Acid	HEDP	2931.9090.00.00	220-552-8 2809-21-4	1.160 kg
3	Laurylbenzene Sulfonic Acid	LABSA	3402.1100.00.00	248-289-4 27176-87-0	1.175 kg
4	Sodium Lauryl Ether Sulfate	SLES N70	3402.1190.00.00	221-416-0 3088-31-1	1.200 kg
5	1,2,3- Propanetriol	Glycerine (technical)	2905.4500.00.00	200-289-5 56-8 1-5	2.500 kg
6	Poly(oxy-1,2 ethanediyl),alpha-(2- propylheptyl)- omega hydroxy	MERSIL EM 0346(silicone emulsion)	3910.0000.00.12	160875-66-1	500 kg
7	Poly(oxy-1,2- ethanediyl),alpha-(2- propylheptyl)- omega hydroxy	COSBASE RP (silicone emulsion)	3910.0000.00.00	160875-66-1	500 kg

Ne Fabriken e prodhimit të produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina Komponentet ndihmëse perdoret uji i destiluar per prodhim sepse produkti del me kualitet.

Ndersa komponentet ndihmse jane:

- Energjia elektrike,
- Uji per nevoja te pastrimit dhe nevoja sanitare.

#### **d) Përshkrimi detal i procesit teknologjik**

Procesi i prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina përfshin disa faza. Më poshtë është një përmbledhje e procesit tipik teknologjik të përfshirë:

#### **Zhvillimi i formulimit:**

Ekipet e kërkimit dhe zhvillimit punojnë në krijimin e formulimeve që pastrojnë, detajojnë dhe ofrojnë aromë për makinat.

Formuluesit zgjedhin surfaktantët e duhur, tretësit, agjentët pastrues, aromat dhe aditivë të tjerë bazuar në vetitë e tyre të pastrimit, përputhshmërinë dhe sigurinë për sipërfaqet e automobilave.

#### **Sjellja e lëndës së parë:**

Lëndët e para si surfaktantët, tretësit, aromat, ngjyrat dhe kimikatet e tjera merren nga furnitorë të miratuar. Furnizuesit zgjidhen bazuar në cilësinë, qëndrueshmërinë dhe përputhshmërinë e materialeve të tyre me standardet rregullatore.

#### **Përzierja dhe përzierja:**

Lëndët e para maten dhe përzihen sipas recetës së formulimit.

Pajisjet e përzierjes si rezervuarët, reaktorët dhe trazuesit përdoren për të siguruar përzierjen e plotë të përbërësve. Mund të kërkohet emulsifikimi për formulime të caktuara për të krijuar emulsione të qëndrueshme.

#### **Mbushja dhe paketimi:**

Produkti i përzier mbushet në enë të tilla si shishe, kanaçe ose shishe sprej.

Pajisjet e mbushjes variojnë nga sistemet manuale në ato të automatizuara në varësi të vëllimit të prodhimit.

Kontejnerët mbyllen, etiketohen dhe paktohen për shpërndarje.

#### **Kontrolli i cilësisë:**

Gjatë gjithë procesit të prodhimit, masat e kontrollit të cilësisë zbatohen për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e produktit.

Mostrat testohen për attribute të tilla si pH, viskoziteti, efikasiteti i pastrimit, qëndrueshmëria dhe intensiteti i aromës.

Testimi mikrobik kryhet për të siguruar që produktet plotësojnë standardet e higjienës.

#### **Pajtueshmëria rregullatore:**

Prodhuesit duhet t'u përmbahen kërkesave rregullatore që rregullojnë prodhimin dhe etiketimin e produkteve të pastrimit dhe detajimit të automjeteve.

Pajtueshmëria përfshin marrjen e certifikatave të nevojshme, kryerjen e vlerësimeve të sigurisë dhe sigurimin e etiketimit të saktë të përbërësve dhe udhëzimeve të përdorimit.

#### **Testimi dhe vlerësimi:**

Produktet i nënshtrohen testimit dhe vlerësimit për t'u siguruar që ato përmbushin standardet e performancës dhe pritshmëritë e klientëve.

Testimi në terren mund të kryhet për të vlerësuar performancën e produktit në kushte të botës reale dhe për të mbledhur reagime për përmirësimin e produktit.

#### **Paketimi dhe etiketimi:**

Dizajni i paketimit është finalizuar dhe etiketat janë printuar me informacionin e produktit, udhëzimet e përdorimit, paralajmërimet e sigurisë dhe detajet e pajtueshmërisë rregullatore. Materialet e paketimit zgjidhen për qëndrueshmëri, mbrojtje të produktit dhe qëndrueshmëri mjedisore.



**Shpërndarja dhe marketingu:**

Produktet e gatshme u shpërndahen shitësve me pakicë, dyqaneve të automobilave dhe kanaleve online. Përpjekjet e marketingut përfshijnë reklamat, promovimet dhe demonstrimet e produkteve për të tërhequr klientët dhe për të ndërtuar ndërgjegjësimin e markës.

Duke ndjekur këto hapa, prodhuesit sigurojnë prodhimin e produkteve me cilësi të lartë pastrimi, detajimi, shampoje dhe aromash të përshtatura për përdorim në automobil.

Gjatë gjithë procesit, ndiqen protokollet e sigurisë për të garantuar mirëqenien e punëtorëve dhe mjedisin. Për më tepër, pajtueshmëria me standardet rregullatore në lidhje me trajtimin, etiketimin dhe asgjësimin e kimikateve është thelbësore për të garantuar sigurinë e produktit dhe përgjegjësinë mjedisore.


**Produktet Finale që do të prodhohen nga kompania “RUNFILL” SH.P.K.**




SHAMPON SHKUMË PËR AUTOLARJE – PRODUKTE PREMIUM	
	<p><b>FAST / Shampo Shkumë - PA Prekje</b></p> <p>Detergjent i lëngshëm për larjen e makinave pa furçë. Është i përshtatshëm për përdorim si në sistemet me shkumë ashtu edhe në ato jo të shkumëzuara. Pastron lehtësisht pluhurin, baltën, mizat, insektet, jashtëqitjet e shpendëve dhe shtresat e tjera të papastërtive. Nuk dëmton bojën dhe shkëlqimin e makinës dhe nuk shkakton ndryshk ose korrozion në elementët metalikë të pambrojtur</p>
	<p><b>FAST PLUS / Shampo me shkumë - PA Prekje</b></p> <p>Detergjent i lëngshëm për larjen e makinave pa furçë me aromë lulësh, i përshtatshëm për t'u përdorur si në sistemet me shkumë ashtu edhe në ato pa shkumë. Pastron lehtësisht pluhurin, baltën, mizat, insektet, jashtëqitjet e shpendëve dhe shtresat e tjera të papastërtive. Nuk dëmton bojën dhe shkëlqimin e automjetit. Nuk shkakton ndryshk ose korrozion në sipërfaqe të pambrojtura.</p>


	<p><b>STORM / Shampo me shkumë - PA Prekje</b></p> <p>Shampo me dy përbërës. Një produkt i koncentruar i parfumuar me fuqi të lartë pastrimi për paralarjen e makinave dhe furgonëve, pëlhurave gomuar dhe sipërfaqeve të forta në përgjithësi. Nuk përmban fosfate, ka një kapacitet të shkëlqyer të prodhimit të shkumës. Nuk dëmton veshjet e makinave ose dërrasat e pasme të kamionit.</p>
	<p><b>LAZER / Shampo për vetëshërbim</b></p> <p>Shkuma e saj aktive largon shpejt insektet, vajrat, tymin, mbetjet e hidrokarbureve dhe në përgjithësi çdo papastërti. Është i ndjeshëm ndaj sipërfaqeve. Përdoret në sistemet e paralarjes dhe shkumës së të gjitha automjeteve. I përshtatshëm për kuti monedhash vetëshërbimi me spërkatje me shkumë.</p>
	<p><b>FLASH -AB / SHAMPON PA PREKJE ME DY HAPA</b></p> <p>FLASH/AB është një pastrues për sistemet pa furça, i krijuar për t'u përdorur në dy faza. Shitet si një grup me dy.</p> <p>1.FAZA: Larja dhe shpëlarja bëhen me FLASH /A. Papastërtitë organike pastrohen.</p> <p>2.FAZA: larja dhe shpëlarja bëhen me FLASH /B. Pastron papastërtitë inorganike.</p> <p>Në këtë mënyrë, ju mund të arrini rezultate perfekte në shërbimin tuaj të larjes së makinave. Plastike, metal alumini etj. Nuk dëmton sipërfaqet.</p>
	<p><b>TITAN / Shampo për Auto</b></p> <p>Detergjent i lëngshëm për larjen e makinave i përshtatshëm për larje me shkumë. Pastron pluhurin, baltën, mizat, insektet, jashtëqitjet e shpendëve dhe shtresat e tjera të papastërtive. Nuk dëmton bojën dhe shkëlqimin e automjetit dhe nuk shkakton ndryshk dhe korrozion në metale të pambrojtura.</p>



	<p><b>AKTIVE / Shampo me shkumë me ngjyra</b></p> <p>Formula e tij e re garanton një efekt të fuqishëm detergjent dhe lustrim, për të pastruar çdo lloj automjeti. Shumë shkumëzues, AKTIVE është i sigurt në pjesët e gomës dhe shkrin pa sforcim çdo lloj papastërtie ( yndyrë, vaj, smog dhe benzinë), duke siguruar një efekt shkëlqyes në të gjitha pjesët plastike.</p>
	<p><b>STAR / Shampo me shkumë - PA Prekje</b></p> <p>Makina, kamionë, makineri bujqësore dhe ndërtimore, trena, autobusë etj. Është një shampo shumë-përdorimshe alkaline shumë e koncentruar për larje si me kontakt ashtu edhe pa kontakt. Kur aplikohet, krijon një shkumë të pasur dhe të lagësht me ngjitje të shkëlqyer edhe në sipërfaqe vertikale. Ai shpërndan në mënyrë të përsosur papastërtitë me vaj në motorët me naftë.</p>
	<p><b>SHOW / LUROSI I THARJE &amp; DYLL</b></p> <p>Ai mbron automjetin tuaj në një mënyrë jashtëzakonisht praktike, të lehtë dhe efektive. Spërkateni në sipërfaqe të lagur, lyeni me sfunjjer dhe shpëlajeni me ujë. Krijon një shtresë filmi në automjetin tuaj. Kjo shtresë siguron shkëlqim të habitshëm dhe largim nga uji.</p>
<p><b>PRODUKTET E KLASËS EKONOMIKE</b></p>	
	<p><b>Shampo me shkume - PA PREKE</b></p> <p>Detergjent i lëngshëm për larjen e makinave pa furçë. Është i përshtatshëm për përdorim si në sistemet me shkumë ashtu edhe në ato jo të shkumëzuara. Pastron lehtësisht pluhurin, baltën, mizat, insektet, jashtëqitjet e shpendëve dhe shtresat e tjera të papastërtive. Nuk dëmton bojën dhe shkëlqimin e makinës dhe nuk shkakton ndryshk ose korrozion në elementët metalikë të pambrojtur.</p>





	<p><b>Shampo me shkumë me ngjyra</b></p> <p>Formula e tij e re garanton një efekt të fuqishëm detergjent dhe lustrim, për të pastruar çdo lloj automjeti. Shumë shkumëzues, AKTIVE është i sigurt në pjesët e gomës dhe shkrin pa sforcim çdo lloj papastërtie ( yndyrë, vaj, smog dhe benzinë), duke siguruar një efekt shkëlqyes në të gjitha pjesët plastike.</p>
---	--



<p><b>PASTRUESIT DHE MIRËMBAJTJE E BRENDSHME - PREMIUM</b></p>	
	<p><b>MILKI / Kujdesi i panelit</b></p> <p>Qumësht silikoni që lustron sipërfaqet prej lëkure, vinyl dhe plastike. Mbron sipërfaqen. Nuk përmban tretës dhe nuk gërryen sipërfaqen. Nuk shkakton mjegull në dritare.</p>
	<p><b>MILKI RED / Kujdesi për pult</b></p> <p>Qumësht silikoni që lustron sipërfaqet prej lëkure, vinyl dhe plastike. Mbron sipërfaqen. Nuk përmban tretës dhe nuk gërryen sipërfaqen. Nuk shkakton mjegull në dritare.</p>
	<p><b>MILKI BLU / Kujdesi dhe Mbrojtja e panelit</b></p> <p>Është krijuar posaçërisht për përdorim në sipërfaqe të veshura me lëkurë dhe vinyl. Mbron teksturën dhe jep një pamje gjysmë mat. Nuk përmban tretës dhe nuk gërryen sipërfaqen. Nuk shkakton mjegull në dritare.</p>


	<p><b>E PËRGJITHSHME / Pastrues Universal</b></p> <p>Përdoret për pastrim të përgjithshëm të pëlhurave, lëkurës, vinilit dhe sipërfaqeve plastike brenda kabinës. Është një tretës vaji i lëngshëm me bazë uji. Duke qenë se është një pastrues i shkëlqyer, pastron lehtësisht njollat e forta. Përdoret për pastrimin e të gjitha llojeve sintetike, pambuku, tapiceri, tapete dyshemeje dhe tavanesh.</p>
	<p><b>TEX POWER / Pastrues për sipërfaqe tekstile</b></p> <p>Përdoret për pastrimin e përgjithshëm të zonave të pëlhurave të brendshme të kabinës së makinës. Është një degreasues i lëngshëm me bazë uji, është një pastrues i shkëlqyer pëlhurash kështu që pastron lehtësisht njollat e forta. Përdoret për pastrimin e të gjitha llojeve sintetike, pambuku, tapiceri, tapeti dhe tavani.</p>
	<p><b>DEORIZER / Auto Parfum</b></p> <p>Ka erë lulësh të egra. Me bazë uji. Mund të përdoret duke u holluar me ujë. Nuk është shqetësim që njerëzit kanë ndjeshmëri ndaj aromave. Nuk ka rrezik për njolla në zonat e aplikuara për shkak se është i pangjyrë. Qëndron për një kohë të gjatë aty ku aplikohet. Ka erë lulësh të egra. Me bazë uji. Mund të përdoret duke u holluar me ujë. Nuk është shqetësim që njerëzit kanë ndjeshmëri ndaj aromave. Nuk ka rrezik për njolla në zonat e aplikuara për shkak se është i pangjyrë. Qëndron për një kohë të gjatë aty ku aplikohet.</p>
<p><b>PRODUKTET EKONOMI KLASS</b></p>	
	<p><b>Kujdesi i panelit</b></p> <p>Qumësht silikoni që lustron sipërfaqet prej lëkure, vinyl dhe plastike. Mbron sipërfaqen. Nuk përmban tretës dhe nuk gërryen sipërfaqen. Nuk shkakton mjegull në dritare.</p>

	<p><b>Pastrues universal</b></p> <p>Përdoret për pastrim të përgjithshëm të pëlhurave, lëkurës, vinilit dhe sipërfaqeve plastike brenda kabinës. Është një tretës vaji i lëngshëm me bazë uji. Duke qenë se është një pastrues i shkëlqyer, pastron lehtësisht njollat e forta. Përdoret për pastrimin e të gjitha llojeve sintetike, pambuku, tapiceri, tapete dyshemeje dhe tavanesh.</p>
	<p><b>Auto Parfum</b></p> <p>Ka erë lulesh të egra. Me bazë uji. Mund të përdoret duke u holluar me ujë. Nuk është shqetësim që njerëzit kanë ndjeshmëri ndaj aromave. Nuk ka rrezik për njolla në zonat e aplikuara për shkak se është i pangjyrë. Qëndron për një kohë të gjatë aty ku aplikohet.</p>


**PASTRUESIT DHE MIRËMBAJTJE E BRENDSHME**


	<p><b>RIM / Rim Cleaner</b></p> <p>Nuk keni nevojë për furçë për të pastruar rrotat dhe gomat. Pastron lehtësisht papastërtitë me vaj dhe pluhurin e jastëkëve. I jep shkëlqim sipërfaqes së pastruar.</p>
	<p><b>BLU SHINE / Shiner gomash</b></p> <p>Përdoret për ndriçimin e gomave dhe pjesëve plastike. Ajo krijon një shtresë homogjene dhe me shkëlqim mbi gomë dhe parandalon ngjitjen e pluhurit për shkak të strukturës së saj antistatike. Ai nuk përfshin substanca gërryese kështu që nuk shkakton fraktura.</p>

	<p><b>RIMMER / Pastrues rimash dhe motori</b></p> <p>"Detergjent i koncentruar me dy komponentë. Produkti me bazë alkaline shpërndan menjëherë papastërtitë, blazën dhe dheun me vaj organik dhe inorganik. Kur hollohet mjaftueshëm, rekomandohet edhe për larjen e pjesëve mekanike. Shmangni kontaktin e zgjatur me sipërfaqet e aluminit."</p>
	<p><b>SHKELQJE E KUQE / Shiner gomash- ekstreme</b></p> <p>Shkëlqen, rigjallëron dhe mbron gomat e makinave. Ai mbron gomat e makinave nga plasaritjet, faktorët atmosferikë dhe kimikë. Era e këndshme e tij e lejon gjithashtu të përdoret në pastrimin e tapeteve të gomës së makinave. Nuk është me vaj dhe ngjitës.</p>
	<p><b>INSEKT / Pastrues insektesh</b></p> <p>Pastrues special për heqjen efektive të mbetjeve të insekteve në sipërfaqet e automjeteve. Larguesi i insekteve përmban përbërës të veçantë aktivë të cilët largojnë mbetjet tipike të insekteve (proteina, gjak, kitinë) duke mos lënë mbetje.</p>
	<p><b>MOTOBRIILL / Pastrues motori</b></p> <p>Degreasuesi i bazës së ujit është projektuar për të hequr shpejt vajin, yndyrën, papastërtitë dhe papastërtitë e grumbulluara në rrugë nga ndarjet e motorit, pusët e parafangove dhe bllokimet e dymit. Gjithashtu i shkëlqyeshëm për pajisje të rënda, makineri, pjesë, vegla, dyshe dhe më shumë. Shpëlahet pastër dhe nuk lë asnjë shtresë vaji ose mbetje. Jo i ndezshëm dhe i biodegradueshëm.</p>


	<p><b>HERO / Degradues</b></p> <p>Është një produkt pastrues ekstra i fuqishëm jo i ndezshëm për të shpejtë dhe shumë efektiv nga qelqi, inoksi, gize, hekuri, qeramika dhe sipërfaqe të tjera jo poroze. Është gjithashtu shumë efektiv për heqjen e depozitave organike, yndyrat, vajrat, djegiet, pluhurin dhe të tjera. Mund të përdoret gjithashtu për pastrimin e xhamit dhe dyerve të vatrave, sobave, skarave, furrave të pjekura, pllakave qeramike etj.</p>
---	---

**PRODUKTET EKONOMI KLASS**

	<p><b>Pastrues i rripit</b></p> <p>Nuk keni nevojë për furçë për të pastruar rrotat dhe gomat. Pastron lehtësisht papastërtitë me vaj dhe pluhurin e jastëkëve. I jep shkëlqim sipërfaqes së pastruar.</p>
--	--

	<p><b>Shiner gomash</b></p> <p>Përdoret për ndriçimin e gomave dhe pjesëve plastike. Ajo krijon një shtresë homogjene dhe me shkëlqim mbi gomë dhe parandalon ngjitjen e pluhurit për shkak të strukturës së saj antistatike. Ai nuk përfshin substanca gërryese kështu që nuk shkakton fraktura.</p>
---	---

**PRODUKTET PREMIUM**

	<p><b>MILKI / Kujdesi për pult</b></p> <p>Qumësht silikoni që lustron sipërfaqet prej lëkure, vinyl dhe plastike. Mbron sipërfaqen. Nuk përmban tretës dhe nuk gërryen sipërfaqen. Nuk shkakton mjegull në dritare.</p>
---	---

	<p><b>BLU SHINE / Shiner gomash</b>                  Përdoret për ndriçimin e gomave dhe pjesëve plastike. Ajo krijon një shtresë homogjene dhe me shkëlqim mbi gomë dhe parandalon ngjitjen e pluhurit për shkak të strukturës së saj antistatike. Ai nuk përfshin substanca gërryese kështu që nuk shkakton fraktura.</p>
	<p><b>BLLAKI / Shkëlqim dhe mbrojtje hidrofobike gomash</b>                  Produkt lustrim hidrofobik i gomave. Krijon një shtresë filmi në gomat tuaja dhe ju jep goma të reja. Falë veçorisë së tij kundër ujit, gomat tuaja qëndrojnë të zeza për ditë të tëra.</p>
	<p><b>GARDI / Motor Protect</b>                  "Produkt lustrimi i motorit. Lahet dhe aplikohet në motor të pastër të thatë. Ai vonon ndotjen duke krijuar një shtresë filmi në sipërfaqen e aplikuar. Falë veçorisë së tij kundër ujit, motori mbetet i pastër për një kohë të gjatë. Mos e aplikoni në një motor të nxehtë. "</p>
	<p><b>PW-65 / De-akulli</b>                  "Easily ju lejon të drejtoni makinën duke zgjidhur akullin e xhamit, pasqyrave dhe bravave në ditët e ngrirjes. Nuk dëmton ngjyrën e automjetit, plastikës dhe metalit."</p>
	<p><b>STEAM/ Kundër mjegullës</b>                  Parandalon mjegullimin e xhamit të makinës suaj, ofron pamje të qartë të rrugës. Mund të përdoret e gjithë pasqyra dhe xhami (syze, helmetë, jaht) të ekspozuar ndaj mjegullës. Lehtë për t'u përdorur.</p>

	<p><b>SPEED / Pastrues i rripit</b>                  Nuk keni nevojë për furçë për të pastruar rrotat dhe gomat. Pastron lehtësisht papastërtitë me vaj dhe pluhurin e jastëkëve. I jep shkëlqim sipërfaqes së pastruar.</p>
	<p><b>GENERAL/ Pastrues universal</b>                  Përdoret për pastrim të përgjithshëm të pëlhurave, lëkurës, vinilit dhe sipërfaqeve plastike brenda kabinës. Është një tretës vaji i lëngshëm me bazë uji. Duke qenë se është një pastrues i shkëlqyer, pastron lehtësisht njollat e forta. Përdoret për pastrimin e të gjitha llojeve sintetike, pambuku, tapiceri, tapete dyshemeje dhe tavanesh.</p>
	<p><b>SHOW / Dyll dhe lustrim</b>                  Ai mbron automjetin tuaj në një mënyrë jashtëzakonisht praktike, të lehtë dhe efektive. Spërkateni në sipërfaqe të lagur, lyeni me sfungjer dhe shpëlajeni me ujë. Krijon një shtresë filmi në automjetin tuaj. Kjo shtresë siguron shkëlqim të habitshëm dhe largim nga uji.</p>
	<p><b>INSECT / Pastrues insektesh</b>                  Pastrues special për heqjen efektive të mbetjeve të insekteve në sipërfaqet e automjeteve. Larguesi i insekteve përmban përbërës të veçantë aktivë të cilët largojnë mbetjet tipike të insekteve (proteina, gjak, kitinë) duke mos lënë mbetje.</p>
	<p><b>DEODORIZER / Auto parfum</b>                  "Ka erë lulesh të egra. Me bazë uji. Mund të përdoret duke u holluar me ujë. Nuk shqetëson që personat janë të ndjeshëm ndaj aromave. Nuk ka rrezik për njolla në zonat e aplikuara për shkak se është i pangjyrë. Qëndron për një kohë të gjatë aty ku aplikohet."</p>
	<p><b>EMULZION / Kujdesi për lëkurën</b>                  Është zhvilluar posaçërisht për kujdesin dhe mbrojtjen e të gjitha sipërfaqeve të mbuluara me lëkurë natyrale. I jep një butësi natyrale indit pas aplikimit. Ajo vonon plasaritjen dhe lë pas një aromë të këndshme me thelbin e saj të veçantë.</p>

**PRODUKTET EKONOMY KCLASS**



**Set për kujdes dhe pastrim**

Produktet tona 750 ml shiten në pako me 12 copë. Paketa përfshin katër lloje produktesh. Roda: 3 x 750 mL Ndriçues: 3 x 750 mL Shpejtësia: 3 x 750 mL Aroma: 3 x 750 mL

**Skema e Procesit teknologjik te prodhimit**




Figura 7 Skema e procesit teknologjik



e) **Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit**

Me poshtë do ti përshkruajmë te gjitha emetimet e pritura gjate fazës se operimit:

- **Uji:** Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së kompanise nuk ka pesuar ndyshime dhe nuk ka ndikuar negativisht ku ndotja është minimale, kompania ka ndertuar sistemin gypor të largimit te ujerave atmosferik dhe atyre fekal edhe pse sasia e ujerave te shkarkuara fekale eshte shume e vogël. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për pastrim te dyshemese, per nevoja te tualeteve si dhe nevoja te pastrimit te makinerive. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për te gjitha nevojat e kompanisë, pas përdorimit te tij do te shkarkohet në rrjetin e kanalizimit te lagjes. Uji perdoret shume pak sepse tani per tani jane vetem 2 punetor. Uji per prodhim perdoret uji i destiluar i cili blehet ne fuqi prej 1000 lit. Ndikimi kryesor i ndotjes se ujerave janë shkarkimet e ujerave te pa trajtuara por zona ku eshte e ndertuar fabrika e kompanise shkarkohet ne kolektorin kryesor i cili pastaj shkarkohet ne impiantin kryesor te qytetit per trajtim.
- **Ajri:** Ky aktivitet nuk parashihet përdorimin te lëndëve djegëse, procesi teknologjik i prodhimit nuk paraqet rrezik potencial per ndikim ne ajer, ndotja e ajerit mund te vije nga levizja e makinave qe levizin ne rrugen rajonale ne afersi te fabrikes.
- **Dheu** – duke konsideruar kapacitetet e projektuara, si dhe si rezultat i investimit adekuat – kontakti i ujërave nga brenda lokacionit të projektit me ujërat sipërfaqësore është izoluar - mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.
- **Zhurma** – gjate operimit mund te ketë zhurmë gjate lëvizjes se makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjate operimit është minimale.
- **Dridhjet** – Dridhjet të tokës, tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim.
- **Drita, nxehtësia dhe rrezatimi** – Janë tri dukuri qe te trijat se bashku te ndihmojnë ne realizimin e punës ku Lokacioni ku është ndërtuar objekti te cilin e shfrytëzon kompania “RUNFILL” SH.P.K. ka drite, rrezatim diellor dhe nxehtësi te mire e cila ndihmon ne kursimin e energjise elektrike.

- **Flora dhe Fauna** – Në rast se kemi derdhje apo shkarkim nga ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Ndikimet në florë dhe faunë janë minimale.
- **Ndikimet sociale dhe ekonomike** – mund të themi lirisht se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal.

Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku pritet të rritet nr. I të punësuarve me fillimin e prodhimit. Ky Projekt ka ndikuar pozitivisht në ekonominë Vendore dhe lokale.

#### **4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME**

Duke e pasur parasysh se hapësira ku është nderuar fabrika e prodhimit të kemikaleve dhe produkteve tjera për pastrim dhe arome të makinave, është përzgjedhur në atë mënyrë që të jetë sa më afër levizjeve të shumta të makinerive dhe po ashtu të ruaj shëndetin e njeriut.

Me poshte do të paraqesim disa alternativa dhe konsiderata:

**Analiza e tregut:** është kryer një analizë e plotë të tregut për të identifikuar kërkesën e produkteve të cilat shiten dhe prodhohen nga kompania “RUNFILL” SH.P.K.. Jane marre parasysh dendësinë e popullsisë, modelet e trafikut dhe konkurrenca e zonës.

Eshte analizuar ndertimi i objektit te ri dhe atij me qera se cili do te ishte me i sukseshem ne rast te ndertimit apo te shfrytezimit te objektit te ndertuar.

**Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis:** është bere vlerësim I plotë I ndikimit mjedisor për të siguruar përputhjen me rregulloret lokale dhe për të minimizuar ndikimin e mundshëm mjedisor të një fabrike për prodhimin e produkteve të lehta, shamponave për pastrim dhe detajim të makinave.

**Zhvillimet me përdorim të përzier:** Fabrika do të integrohet në një zhvillim me përdorim të përzier që përfshin hapësirat e shitjes me pakicë dhe prodhimit. Kjo qasje mund të rrisë qëndrueshmërinë ekonomike dhe integrimin e komunitetit.

**Platformat në internet dhe shërbimet e dorëzimit:** Eksplorimi i platformave të internetit për shërbimet e shpërndarjes së produkteve të shitjes dhe prodhimit. Në disa zona, kërkesa për shpërndarjen e produkteve të cilat shiten dhe prodhohen nga “RUNFILL” SH.P.K. sipas kërkesës është në rritje, dhe kjo mund të jetë një alternativë për një Fabrike të prodhimit në afërsi të këtyre zonave.

**Stimujt e qeverisë:** Hetimi i çdo stimulues ose grant qeveritar për projekte të qëndrueshme ose alternative të energjisë. Qeveritë mund të ofrojnë mbështetje për projekte që përputhen me qëllimet mjedisore.

**Përmirësimi i së ardhmes:** Është merrë parasysh qëndrueshmërinë afatgjate e fabrikes dhe me rritjen e kërkesave për pastrim të automjeteve elektrike dhe ndryshimin e peizazheve, siguroemi që modeli i biznesit të jetë i adaptueshëm ndaj ndryshimeve të ardhshme.

**Zonimi dhe lejimi:** Kuptimi i rregulloreve lokale të zonimit dhe kërkesat e lejeve. Kjo përfshin pajtueshmërinë me standardet e sigurisë, rregulloret e përdorimit të tokës dhe konsiderata të tjera ligjore.

Kompania “RUNFILL” SH.P.K. ne mungese të mjeteve financiare dhe ne mungese të një lokacioni të sajë privat, e ka parë si alternativën më të mirë që të marrë objekt me qera në afërsi të qytetit ku edhe kërkesat janë më të mëdha dhe kjo alternative ka rezultuar si më e sukseshme.

## **5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT**

Në Komunën e Prizrenit ashtu si në të gjithë Kosovën, çështja e mjedisit, për fat të keq, nuk ka qenë për një kohë të gjatë në listën e prioriteteve të politikbërësve. Edhe sot, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politikbërësve qoftë në nivelin qendror. Në bazë të hulumtimeve dhe vlerësimeve të bëra, komuna e Prizrenit ballafaqohet me probleme mjedisore të ndryshme siç janë: mungesa e ujit të pijes, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza në fshatra sepse sa i përket qendres së Prizrenit ajo tash më ka impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura, një problem shumë i madh është menaxhimi jo i mirë me mbeturinën, menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore, ndërrimi i destinacionit të shfrytëzimit të tokës bujqësore, urbanizimi i pa kontrolluar, shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve, prerja e pyjeve dhe mungesa e ripyllëzimeve, hapësirat e pamjaftueshme të gjelbëruara në qytet, mungesa e sistemit të monitorimit të medimeve mjedisore etj.

Lokacioni ku është vendosur fabrika për prodhimin e produkteve tashme ka marrë karakterin e zonës industriale për prodhim të lehta dhe në afërsi kalon rruga dy kahore e cila lidhet me Komunën e Prizrenit me të gjitha komunat tjera sepse lidhet në autostradën Ibrahim Rugovë.

Lagjia arbana-dushanova i plotëson të gjitha kushtet për industrinë e lehtë sepse ka energji elektrike të rregullt, menaxhim të mbeturinave, nuk ka shtëpi të banuara, shetpites me të afërta janë mbi 100m. Gjithashtu Lagjia arbana është e urbanizuar mirë dhe i posedon të gjitha kushtet për zhvillim të jetesës dhe punës, është një lagje më e qetë sepse gjendet në perëndim të komunes.

### **5.1 Ndotsit Kryesorë**

Përdorimi i drurit për ngrohje është njëri nga kontribuesit më të mëdhenjë të ndotjes së ajrit dhe burimi kryesor i pluhurit grimcor. Ndotsit më të mëdhenjë nga zjarri i drurit janë pluhuri grimcor, karboni i zi, hidrokarbonet poli-aromatike dhe dioksinat. Përveç tjerash, zjarri nga druri shkakton edhe oksidet e azotit dhe monoksidin e karbonit. Në Kosovë zjarri nga druri që përdoret kryesisht në sektorin e banimit përbën rreth 20% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Bazuar në përllogaritjet e GAINS, sektori i banimit përbën gati gjysmën e emetimeve të pluhurit grimcor PM2.5 dhe pothuajse 80% të emetimeve të karbonit të zi për vitin 2015.

Komuna e Prizrenit nuk posedon sistem të ngrohjes qendrore, prandaj shumica dërmuese e banorëve shfrytëzon drurin si burim të vetëm për ngrohje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ajrit, në veçanti gjatë periudhës së dimrit. Nga gjithsejtë 28,682 objekte banimi, 26,070 shfrytëzojnë drurin për ngrohje, ndërsa 2061 banorë përdorin energjinë elektrike. Në masë më të vogël përdoret thëngjilli, nafta dhe gazi natyror.

### **5.2 Transporti rrugor**

Transporti është përgjegjës për më shumë se dy të tretat e emetimit të oksideve të azotit (NOx) dhe me përreth 10% të emetimit të përgjithshëm të ndotësve tjerë. Transporti rrugor në veçanti vazhdon të përbëj pjesën më të konsiderueshme të ndotësve kryesorë të ajrit (me përjashtim të oksideve të sulfurit). Përderisa emetimet nga transporti rrugor janë kryesisht lirime të gazrave nga djegia e karburanteve, emetimet jo-shkarkimore kontribuojnë poashtu në lirimimin e përbërjeve organike të paqëndrueshme jo-metanore (NMVOC) si dhe grimcat e pluhurit parësor (nga shpenzimi i gomave, frenave dhe abrazioni i rrugëve). Emetimet e PM2.5 parësor janë rritur për 22% nga viti 2000 ndërsa emetimet jo-shkarkimore janë rritur poashtu si rezultat i futjes në përdorim të teknologjive për zvogëlimin e lirimimit të grimcave nga automjetet.

Vjetërsia e automjeteve vazhdon të jetë problemi thelbësor në emetimet e ndotjes. Vlerësohet se mosha mesatare e veturave është 18 vjet, ku numri më i madh i tyre është me vit prodhimi 2002 (23,038 vetura), 2003 (23,146 vetura) dhe 2004 (20,836 vetura).

### **5.3 Mbeturinat e ngurta**

Mbeturint komunale permbajne nje game te gjere te ndotesve, perfshire metalet e rënda, cianidin (CN), Hidrokarburet policiklike, bifenilet e polikloruara, azbestin, metanin, amoniakun dhe hidrogjen sulfidet të cilat kanosin tokat përreth. Klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas Ligjit

nr. 04/L-060 për mbeturina dhe ndahen në mbeturina komunale, komerciale, industriale dhe medicinale. Ndersa sipas nivelit të rrezikshmerise ndahen ne mbeturinaInerte, te parrezikshme, dhe të rrezikshme. Komuna e Prizrenit ka deponine rajonale te mbeturinave ne fshatin Landovicë. Mbeturinat Komunale të Prizrenit deponohen në deponinë regjionale në Landovicë, e cila menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës Sh.A. (KMDK). Deponia në Landovicë e cila u shërben edhe komunave të Rahovecit, Malishevës, Suharekës, Mamushës dhe Gjakovës është ndërtuar në vitin 2003 dhe ka filluar të operojë në vitin 2004.

#### **5.4 Ndotësit nga burimet agro-kemikale**

Ndotësit nga burimet agro-kemikale përfshijnë fertilizuesit, plehun organik dhe pesticidet. Efektet ndotëse më të mëdha nga fertilizuesit dhe plehu organik konsiderohen të jenë futja e metaleve të rënda dhe komponimeve të tyre në dhe.

### **6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS**

Investimi në fabrikën e prodhimit të produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte që do të ofroj si dhe për mundësitë e punësimit. Ndikimet në mjedis janë shume minimale mos te themi fare nuk kanë ndikim në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Gjatë punës kontinuele të fabrikes se prodhimit te produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga levizja e makinave derdhjet eventuale te lendes se pare apo produktit final, krijohet zhurmë ngalevizjet e makinave ne rrugen ne afersi te fabrikes. Në mënyrë indirekte mund të vjen edhe te deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut ne rast te dershjes apo prishjes se produktit final apo lendes se pare.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e perfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndertuar objekti te cilin e shfrytëzon kompania “RUNFILL” SH.P.K.. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit),

biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

### **6.1 Ndikimet në ajër**

Gjatë funksionimit të Fabrikes së prodhimit të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina nga qarkullimet e automjeteve vjen deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga automjetet. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentrimet të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë: CO, NO<sub>x</sub>, HxCy, SO<sub>2</sub> dhe Pb. Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin ku fabrika e kompanisë “RUNFILL” SH.P.K. e zhvillon aktivitetin e sajë.

### **6.2 Ndikimet në tokë**

Toka si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja. Në fazën e shfrytëzimit të objektit të fabrikes së prodhimit të produkteve për pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga kulmet dhe sipërfaqja manipuluese e platos së objektit të fabrikes dhe nga fundërrim et e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të fabrikes së prodhimit, pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vjen si pasojë e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër fabrikes varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin.

### **6.3 Ndikimet në ujë**

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është nëse vjen deri te shpërthimet e fuqive me të cilat sillet lenda e pare dhe po ashtu ne rast se demtohet ndonje kante ne te cilen mbushet prodhimi i shamponave, por ndotja do te jete shume e vogel per arsye se prodhimi i produkteve eshte miqesor me natyren. Koncentrimi i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpëlarja apo nga të

reshurat atmosferike ku koncentrimet më të mëdha janë në 5-10 minutat e para të shpëlarjes së sipërfaqes së pllatores nga personeli apo nga të reshurat atmosferike.

#### **6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë**

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vjen deri te ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe në platonë e objektit të fabrikes kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentrim të vogël. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, se fauna edhe ma herët nuk ka ekzistuar në këtë lokacion sepse fabrika e prodhimit është ndërtuar në lokacionin që kanë ekzistuar vendbanime.

#### **6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë**

Hapësira ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania “RUNFILL” SH.P.K. nuk ka ndikim negativ në popullatën e zonës pasi që lokacioni ku është bërë ndërtimi është zone ndërtimore për biznese për të cilin Objekti ka qenë i ndërtuar po ashtu është brenda kushteve të legjislacionit primar dhe sekondar. Në të kundërtën, ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal.

#### **6.6 Ndikimet nga zhurma**

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj. Lokacioni i fabrikes së kompanisë “RUNFILL” SH.P.K. me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve dhe një zhurmë të cilën e lëshon makina e mbushjes e cila është brenda kufijve të lejuar. Sipas gjendjes faktike të kompleksit në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli i zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB.

#### **6.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore**

Në rast aksidentesh ose katastrofave, në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me në fabriken e prodhimit, vërejtje deri tek problemi me energji elektrike ndërsa rrezik nga ndonjë aksident tjetër nuk mund të ketë. Masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave, analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza: identifikimi i rrezikut, analiza e pasojave dhe vlerësimi i rrezikut, me qëllim të parandalimit të këtyre fatkeqësive eventuale.

### **6.8 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat**

Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi i tyre - mbeturinat te cilat gjenerohen gjatë aktivitetit të fabrikes se prodhimit të produkteve per pastim - detajim, shamponëve dhe aromave për makina, të ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në djeponit regjionale për trajtim të mbeturinave.

Table 1 Mbeturinat te cilat gjenerohen nga kompania

Kodet e Mbeturinave	Emri i Mbeturinės	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i Deponimit
20 01 01	Letër dhe Karton	Jo të rrezikshme	Kontejner
20 01 08	Mbeturinat e biodegradueshme nga kuzhinat	Jo të rrezikshme	Kontejner

Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave - gjatë aktivitetit te fabrikes se prodhimit, bëhet magazinimi i përkohshëm i mbeturinave të ngurta komunale të cilat grumbullohen dhe vendosën në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim. Mbetjet urbane deponohen ne kontejner dhe menaxhohen nga kompania lokale e qytetit, si mbetjet urbane tjera. Menaxhimin e mbeturinave - klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave Kompania e bene ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

### **6.9 Trashëgimia Kulturore**

Si pas hulumtimit te materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar ne teren dhe Komunë, ne lokacionin e ngushte, ku gjendet fabrika e kompanise “RUNFILL” SH.P.K., nuk kemi monumente te trashëgimisë kulturore, historike e natyrore te cilat eventualisht do te ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë se Kompanise ne fjale.



## **7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS**

Ndërtimi i fabrikes se prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “RUNFILL” SH.P.K mund të ketë pasoja të ndryshme mjedisore gjatë fazës së Operimit. Është e rëndësishme të theksohet se ndikimi specifik mund të ndryshojë në varësi të faktorëve të tillë si vendndodhja, dizajni dhe pajtueshmëria rregullatore.

Këtu janë disa pasoja të mundshme:

**Çrregullimi i tokës:** në fazen e ndërtimit, ka patur shqetësime të konsiderueshme të tokës, duke përfshirë gjurmimin, klasifikimin dhe heqjen e bimësisë. Kjo mund të çojë në erozionin e tokës, ndërprerjen e habitatit dhe ndryshimin e modeleve natyrore të kullimit.

**Ndotja e ujit:** Aktivitetet e ndërtimit mund të sjellin ndotës në trupat ujorë të afërt përmes rrjedhjeve. Ndotës të tillë si sedimentet, kimikatet e ndërtimit dhe rrjedhja e derivateve nga makinerite mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit dhe ekosistemet ujore.

**Cilësia e ajrit:** Aktivitetet e trafiku ne afersi te fabrikes mund të kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Emetimet nga pajisjet e ndërtimit dhe automjetet, mund të çlirojnë ndotës si grimcat, oksidet e azotit dhe komponimet organike të paqëndrueshme.

**Zhurma dhe ndotja nga drita:** Operacionet brenda fabrikes mund të gjenerojnë zhurmë dhe ndotje, duke prishur mjedisin përreth dhe duke ndikuar potencialisht në kafshët e egra aty pranë, duke përfshirë speciet e natës.

**Ndotja e ujërave nëntokësore:** Derdhja eventuale e lendes se pare si dhe produktit final mund te paraqesin rrezik për rrjedhje, duke çuar në ndotjen e ujërave nëntokësore.

**Gjenerimi i mbetjeve:** Fabrika per prodhim të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina, gjenerojnë lloje të ndryshme mbetjesh, duke përfshirë vajin e përdorur, filtrat dhe materiale të tjera të rrezikshme. Hedhja e gabuar e këtyre mbetjeve mund të çojë në ndotje të tokës dhe ujit.

**Bllokimi i trafikut dhe ndikimi në infrastrukturë:** Rritja e trafikut ne afersi te fabrikes mund të kontribuojë në mbi popullim dhe të stresojë infrastrukturën lokale. Kjo mund të çojë në ndërtim dhe mirëmbajtje shtesë të rrugëve, duke ndikuar më tej në mjedisin përreth.

**Ndikimi ekologjik:** Prania e fabrikes se prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina mund të prishë ekosistemet lokale dhe biodiversitetin. Shkatërrimi i habitateve gjatë ndërtimit dhe shqetësimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore mund të prekë speciet bimore dhe shtazore në zonë.

**Pajtueshmëria rregullative:** Mosrespektimi i rregulloreve mjedisore mund të çojë në pasoja ligjore, gjoba dhe kërkesë për masa korrigjuese.

Zbutja e këtyre pasojave mjedisore shpesh përfshin zbatimin e praktikave më të mira, respektimin e rregulloreve mjedisore dhe miratimin e teknologjive dhe praktikave që minimizojnë ndikimin e ndërtimit dhe funksionimit i fabrikes se prodhimit në ekosistemin përreth.

## **8. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE**

Metodat te cilat janë përdorur për Vlerësimin e pasojave Mjedisore paraqiten si me poshtë:

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike menaxhimi i trajtimit të çështjeve mjedisore. Si e tillë, ajo plotëson dhe përforcon një metodë sistematike në menaxhimin e përgjithshëm të një organizate; dhe organizatat me një menaxhim të shëndoshë përgjithësisht kanë një performancë më të mirë përmes një metode proaktive dhe të përgjithëshme për zgjidhjen e aspekteve të veprimeve të saj. E kundërta e menaxhimit sistematik është reagimi ndaj vendimeve të marra rregullimi i gjërave kur ato prishen, të kuptuarit se si duhet vepruar kur ka një kërcënim të gjobave dhe padive ose kur përballësh nga konkurrentë më të efektshëm. Marrja e vendimeve të shpejta rrallë është një menaxhim i mirë. Në disa raste, organizatat i përfshijnë Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit, sepse ata tashmë e kishin një sistem të mirë menaxhimi; në raste të tjera Sistemi i Menaxhimit Mjedisor çon në një menaxhim të përgjithshëm më të mirë duke hapur rrugën përmirësimit të përgjithshëm të veprimeve, dhe futjen e praktikave të mira të menaxhimit aty ku ato nuk kanë ekzistuar më parë. Në rastin e Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit, ka edhe përfitime të veçanta: kursime në kosto, përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme, përmirësimi i marrëdhënieve me autoritetet, zvogëlimi i rrezikut në aspektin e detyrimeve mjedisore, përmirësimi i motivimit të punonjësve, përmirësimi i shëndetit në punë dhe një performancë më të mirë mjedisore.

**Kursime në kosto:** Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kërkojnë praktika për parandalimin e ndotjes, që në mjaft organizata sjellin kursime financiare. Në një fabrikë prodhimi pa aktivitete të mëparshme mjedisore, shpesh gjysma e ndotjes mund të parandalohet me investime të vogla dhe me procese të thjeshta përmirësimi ose me një qeverisje të mirë të brendshme. Në vendet Evropiane, tarifat e nënshtruara të shkarkimit dhe tarifat për hedhjen e mbeturinave janë shpesh herë mjaft më të larta se kostoja e aktiviteteve për parandalimin e ndotjes, në këtë mënyrë gjëndërohen përfitime financiare. Gjithashtu veprimtaritë dhe teknologjitë për të përmirësuar rendimentin e energjisë, si sistemet efektive të ndriçimit apo gjeneratorët elektrike dhe pompat shpesh janë me leverdi. Kjo do të thotë se ato gjenerojnë kursime në kosto.

**Zvogëlimi i rrezikut:** Menaxhimi sistematik i rrezikut është një detyrë e përgjithshme për çdo organizatë, dhe një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të mbështetë menaxhimin e rreziqeve nga dhe drejt mjedisit, që mund të parashtrajnë një rrezik për të ardhmen e vetë organizatës, p.sh. nëpërmjet emetimeve që nuk janë të pranueshme për mjedisin ose aksidente që mund të çojnë në detyrime mjedisore ose dëmtim të reputacionit. Shqyrtimi fillestar mjedisor është gjithashtu një vlerësim i rreziqeve mjedisore, duke qenë se ai vlerëson pasojat dhe mundësinë e ndikimeve mjedisore. Plani i veprimit që rrjedh, dhe aktivitetet e tjera të zbatimit të sigurojnë mjetet për të menaxhuar këto rreziqe, duke u përpjekur në reduktimin si të mundësive të tyre dhe të efekteve negative.

**Përputhje me legjislacionin:** Organizatat në Ballkan dhe Evropë, kryesisht ato të përfshira në prodhim, veprojnë në mjedis mjaft të rregulluar: ata duhet të pajtohen me një legjislacion mjedisor të komplikuar. Gjithmonë e më shumë, aktivitetet e rrezikshme për mjedisin kanë nevojë për leje mjedisore. Për një organizatë, pajtimi me legjislacionin mjedisor është një detyrë e rëndësishme, meqenëse mos-pajtimi mund të çojë në detyrime dhe pasoja ligjore për përfaqësuesit ligjorë të organizatës – drejtuesit e lartë të saj. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë ligjore, pasi ato sigurojnë një bazë për identifikimin e legjislacionit të përshtatshëm, kërkesat e zbatueshme dhe kontrollon përputhshmërinë brenda organizatës. Kjo metodë sistematike me përputhshmërinë ligjore ndihmon gjithashtu në përmirësimin e marrëdhënieve të organizatës me autoritet mjedisore.

**Marrëdhënie më të mira me publikun e gjerë:** Aktivitetet e organizatave jo qeveritare dhe protestat publike kundër projekteve që mund të dëmtojnë mjedisin, tregojnë se ndryshimet në shoqëri po ndodhin në nivel global dhe lokal. Konventa Aarhus ndihmon publikun që të ketë një zë në vendimet politike që prekin cilësinë e këtij mjedisi, i ofron publikut akses të lirë në informacion, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e gjykimit për çështjet mjedisore. “Palët e interesuara” si rezidentë, grupet e interesit, media, klientët dhe çdo lloj grupi tjetër apo individ me interes në një çështje, janë tani pjesë e realitetit të një organizate, dhe mënyra më e mirë për tu sjellë me ta është fitimi i besimit nëpërmjet një informimi dhe komunikimi të rregullt dhe të besuar. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ju ndihmon në përgatitjen e të dhënave dhe informacionit që ju duhen për këtë proces komunikimi, ndërsa certifikatat dhe raportimi i rregullt do të mbështesin procesin e fitimit të besimit.

**Përmirësimi i motivimit të punonjësve:** Një nga rezultatet më të paparashikuara në anketat e organizatave që kanë zbatuar Sistemet e Menaxhimit Mjedisor është përmirësimi i motivimit

të punonjësve. Punonjësit përfitojnë drejtpërdrejt nga efektet anësore si përmirësim i shëndeti në punë dhe i kushteve të sigurisë, por gjithashtu ata kujdesen për mjedisin.

**Përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme:** Ka dy tipe kryesore presionesh që do të ndryshojnë tregjet e së ardhmes: Së pari, kufizimet e botës natyrore – çështje si ngrohja globale, pamjaftueshmëria e ujit dhe humbja e biodiversitetit- do të ndrydhin veprimet e kompanise. Së dyti, bizneset përballen me një spektër në rritje të klientëve që janë të shqetësuar për mjedisin. Ato biznese që përballen më mirë dhe që i gjejnë një zgjidhje këtyre sfidave, do të mundin konkurrentët e tyre. Duke rritur ndërgjegjësimin mjedisor brenda organizatës suaj, një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të ndihmojë në zbatimin e hapave të nevojshme si eko-projekti, në mënyrë që të zhvillohen procese dhe produkte që do të jenë të përshtatshme për tregjet e së nesërme, të cilat do të jenë më të ndërgjegjësuara për mjedisin.

## **9. PERSHKRIMI I MASAVE**

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e Fabrikes se Prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit i cili është ndertuar sipas projektit dhe rekomandimeve të dhëna ne këtë raport, fabrika e kompanise “**RUNFILL**” **SH.P.K.**, me zhvillimin e veprimtarisë kontinuele të sajë, mund te themi se nuk rrezikon mjedisin ne maste qe palejueshme, sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vjen deri te ndotja duhet të ndermirren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor. Me qëllim të zvogëlimit të mëtejme të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut nga fabrika e prodhimit te produkteve RUNFILL në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

### **9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër**

Për zvogëlimin e ndotjes se ajrit nga zhvillimi i aktiviteteteve te kompanise “**RUNFILL**” **SH.P.K.**, duhet qe operatori ne fjalë ne temperatura te larta të mirëmbaje dhe ti pastroj ne mënyrë te vazhdueshme sipërfaqen me kubza dhe rrugen ku operon ne mënyrë qe te mos krijohet pluhuri ne ajër, gjithashtu kujdes maksimal duhet te ushtrohet gjate procesit te transportit te produkteve qe prodhohen nga kompania ne mënyrë qe pluhuri mos te kaloj ne ajër dhe kështu te shkaktohet ndotje e ajrit. Ndotja me e madhe ne ajer vjen si pasoje e levizjeve te makinerive ne rrugen ngjitur me parcelen e kompanise.

Megjithatë gjatë operimit do të merren masat:

- Mirëmbajtje e hapësirës manipuluese,,
- Kujdesi maksimal gjate procesit te transportit tr produkteve,
- Mirëmbajtjen e rregullt te makinerisë se punës dhe makinerisë lëvizëse-motorike.

## **9.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë**

Per shkak se komuna e Prizrenit ka ndertuar Impiantin e trajtimit te ujerave te ndotura fekle dhe per shkak te numrit te vogel te punetoreve ndotja ne uje dhe e toke eshte shume minimale dhe shkarkohet direkt ne rrjetin e kanalizimit te qytetit.

Ne parcelen e ku zhvillohet veprimtaria e kopmanise “RUNFILL” SH.P.K. duhet te funksionoj sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative, dhe të dërgohen në Kolektorin kryesor te qytetit. Përveç masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara me larte, investitori duhet të i ndërmerre edhe këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative tëra hapësirat operacionale ne të cilat bëhet manipulimi me produktet finale te prodhimitq jane të mbuluara me kubza betoni
- Furnizimi me ujë pije si dhe për nevoja tjera sanitarie, larje bëhet nga sistemi i ujësjellësit.
- Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat të përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm duhet të grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën ne gypin kryesor te qytetit,
- Ujërat fekale nga nyjat sanitare përmes gypave duhet të dërgohen ne kolektorin kryesor dhe se nuk ka gropë septike per trajtim,
- Të vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tyre duhet të dërgohen për zbrazje ne deponin regjionale.
- Të mbjellen sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara me barë dhe drunj dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe me lart nga ky aktivitet nuk pritet te ketë ndikime ne toke. Ndotja e ujit mund te vije nga larja e pajisjeve, dyshemesë, shkarkimet fekale si dhe mjeteve motorike, pastrimit dhe WC -t do ti trajtoj ne impiant për ujera te ndotura ku pas trajtimi do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimit publik.

### **9.3 Masat për mbrojtje nga zhurma**

Fabrika e Prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina, gjatë ushtrimit të aktivitetit të sajë nuk shkakton zhurme ose mund të shkaktojë një zhurme shumë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku është ndërtuar Fabrika e Prodhimit të kompanisë “RUNFILL” SH.P.K. është afër rrugës Kryesore e cila lidhë qytetin e Prizrenit në drejtim të Komunes së Gjakovës dhe po e njëjta lidhet me autostradën Ibrahim Rugovë, dhe zhurma më e madhe bëhet nga levizja e makinerive, prandaj zhurma që krijohet nga fabrika e prodhimit është thuajse më e vogël se makinat levizin ngadal dhe ato si janë duke u furnizuar duhet të jenë të fikura. Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rendësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurme gjatë procesit të punës.

### **9.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë**

Parcela në lokacionin në të cilën është e vendosur fabrika për prodhimin e produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “RUNFILL” SH.P.K., nuk ka ndikim negativ në peizazh, florë dhe faunë e vendbanimit në fjalë dhe regjionit në përgjithësi.

### **9.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë**

Në afërsi të zonës së ku është e ndërtuar Fabrika për prodhimin e produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina, veç se është rritur vlera të gjitha shtëpive dhe bizneseve sepse afër tyre mund të hapen vende të punës dhe po ashtu mund të furnizohen me produkte cilësore për pastrim të makinave.

### **9.6 Masat rehabilituese**

Pasi që kompania “RUNFILL” SH.P.K. Objektin e shfrytëzon me qera beson se pas përfundimit të aktivitetëve në fabriken e prodhimit, kjo varet nga poseduesi i objektit se sa do të vazhdojë me këtë objekt, nëse nuk vazhdohet me këtë, atëherë objektet ekzistuese duhet të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të inerteve. Të gjitha mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar

nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethinë të lokalitetit dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem

**9.7 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve**

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
<b>Ajri</b>	Ka potencial të vogël për ndotjen e kualitetit të ajrit.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë erërave të forta të cilat mund të bartin pluhurin nga sipërfaqja e parcelës, si dhe nga ndikimi nga djegia e derivateve nga makinat lëvizëse.	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të parcelës, Mirëmbajtja e makinerisë punëse, Mirëmbajtja e makinerisë lëvizëse dhe mos ndezja e motorëve të tyre pa nevojë, Përdorja e lëndës ngrohëse miqësore me ambientin etj.
<b>Uji dhe Toka</b>	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston të dheu dhe ujërat nëntokësore	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i keq menaxhimit të ujërave të shkarkuara nga procesi i pastrimit të paësjeve.	Fabrika e prodhimit në rast se bëritjen e numrit të punetoreve ka planifikuar ndërtimin e gropës septike për trajtimin e ujërave të ndotura të cilat do të shkarkohen nga kuzhina dhe WC-të.
<b>Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e</b>	Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në zhdukje.	Sipërfaqja ku është ndërtuar fabrika e prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania	Me që në vendin ku është ndërtuar fabrika e prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “RUNFILL” SH.P.K. është zone ndërtimore Industriale

<b>mbrojtura të natyrës)</b>		“RUNFILL” SH.P.K. është sipërfaqe e vogël, dhe kjo nuk mund të ndikoj në shkallen e mikrosistemit.	ku ka biznese atëherë nuk ka florë dhe faunë shumë të zhvilluar dhe për rrethe. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikim është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
<b>Zhurma</b>	Potencial minimal	Nga ky aktiviteti i fabrikës së prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompanisë “RUNFILL” SH.P.K. ka potenciale të vogla të shkaktimit të zhurmës,	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim të madh në ambientin jashtëm. Zhurma me e madhe bëhet nga rruga rajonale e cila është e ngjitur me parcelat e kompanisë.
<b>Shëndeti i qytetarëve dhe konsumatorëve</b>	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes së hapësirës manipuluese.	Te gjitha pajisjet të cilat mund të kenë ndikime në shëndetin e qytetarëve do t’iu kushtohet rëndësi e veçanë në mirëmbajtjen e tyre.

### 9.8 Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimin e mbeturinave - klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave, Kompania në fjalë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligjin për Mbeturinën Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina, ato i ruan në kontejner deri sa të merren nga kompania e licencuar. Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.



## **10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE**

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me fabrikën e prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompanisë “**RUNFILL**” SH.P.K. nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djegë ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.

## **11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

**Monitorimi** – shihet qarte se ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komform ligjeve dhe të njoftohen organet kompetente.

**Raportimi** - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë sajë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

## **12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME**

### **12.1 Përshkrimi i shkurtër i procesit**

Objekti ku zhvillohet aktiviteti i kompanisë – fabrikës së prodhimit të produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “**RUNFILL**” SH.P.K. në lokacionin afër regjionale në lagjen arbana – dushanov në Komunën e Prizrenit, përbehet nga:

**Një Objekt- P+0 – me sipërfaqe prej 180 m<sup>2</sup>:**

Në të cilin gjendet vetëm makina për perzirje dhe mbushje të produkteve për pastrim.

w

### **13. PËRFUNDIM**

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në objektet e fabrikes e prodhimit te produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “**RUNFILL**” **SH.P.K** e cila gjendet në Lagjen Arbana te komunes se Prizrenit, të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe duke i zbatuar të gjitha masat e përmendura nga kjo analizë e bërë si dhe duke pasur parasysh kapacitetin e fabrikes dhe mjedisin rrethues të lokacionit mundë të përfundojmë se: Funksionimi kontinual i Fabrikes se Prodhimit te produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “**RUNFILL**” **SH.P.K** është analizuar dhe përshkruar mjaftueshëm lidhur me ndikimet në mjedis dhe rrezikun eventual qe paraqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit ne përgjithësi. Duke u bazuar në natyrën e punes se fabrikes se prodhimit dhe aktivitetit te saje, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit – Fabrike e prodhimit te produkteve për pastrim, detajim, shampo dhe aromë për makina nga kompania “**RUNFILL**” **SH.P.K**, nga Prizreni.

#### **14. LITERATURA E PERDORUR**

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2022/03/Harta-Zonale-e-Komunes-Prizren-2022-2030.pdf>
- [Kërko dhes paraqit - KGP \(rks-gov.net\)](#)
- [OpenStreetMap,](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)